

V E N D I M
Nr.927, datë 28.6.2001

PËR SHPALLJEN E REZULTATIT TË ZONËS ZGJEDHORE NR. 27

Komisioni Qendror i Zgjedhjeve, i mbledhur sot më datë 27.6.2001, me pjesëmarrjen e:

Ilirjan Celibashi	Kryetar
Tomor Malaj	Anëtar
Pandeli Varfi	Anëtar
Igli Toska	Anëtar

pasi shqyrtoi procesverbalet e vendimet e prura nga KZZ nr.27, bazuar në nenin 18 pika 4 të ligjit nr.8609, datë 8.5.2000 “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë”,

V E N D O S I:

Të shpallë rezultatin përfundimtar të zgjedhjeve në zonën zgjedhore nr.27, duke njohur si fitues kandidatin e pavarur për deputet z. Pëllumb Rexhep Berisha, si dhe të shpallë rezultatin përfundimtar (përqindjes së proporcionalit) të subjekteve zgjedhore sipas tabelës bashkëngjitur.

KRYETARI
Ilirjan Celibashi